




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC  
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE MUNICIPAL RAHOVEC / KABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabinet i Kryetarit të Komunës)  
Nr./Br./No 673 Nr. i faq/Br.str./No.pg 160  
Data/Datum/Date 1 / 6 / 2023  
RAHOVEC / ORAHOVAC

# BULETINI MUJOR KOMUNAL - MAJ 2023



**PËRMBAJTJA**

<b>HYRIE.....</b>	<b>2</b>
<b>AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE TË DREJTORËVE TË DREJTORIVE.....</b>	<b>3</b>
<b>PËRFUNDIM.....</b>	<b>14</b>

## HYRJE

*Ky buletin është krijuar me idenë e promovimit të aktivitetave të Kryetarit të Komunës dhe të drejtorëve të drejtoreve, gjatë muajve të vitit 2023.*

*Rrëndësia e botimit të buletinit mëjor qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktivitetave të Komunës së Rahovecit, në mënyrë tillë që t'i mundësojmë qytetarit të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.*

*Muaji maj i vitit 2023, është karakterizuar me një sërë aktivitetesh të Kryetarit dhe të drejtorëve të drejtoreve.*

*Me anë të këtij buletini mëjor për muajin maj, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet e Kryetarit të Komunës dhe të drejtorëve të drejtoreve në Komunën e Rahovecit.*

## AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE TË DREJTORËVE TË DREJTORIVE



Kryetari Smajl Latifi, bashkë me nënkyetarin, Fatmir Iska, drejtorin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Afrim Dina, drejtoren për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Sarandë Sallteku, me bashkëpunëtorë të tjera e miq, si dhe me qytetarë, mësimdhënës e nxënës nga Malësia e Vogël, nisën punimet për fushën e re sportive në hapësirat e Shkollës Fillore "Skender Kastrati".

Në 24-vjetorin e rënies, kryetari Latifi, bashkë me miq e përfaqësues të OVL - UÇK-së, nderuan kujtimin për kontributin e dëshmorit Bajram Sallahaj nga Kazniku.


Heroizmi, qëndrimi dhe sakrificat e tij do të mbesin të paharruara ndër breza dhe do të shërbejnë si udhërrëfyes për të gjithë ne.



Në 24 - vjetorin e rënies, nënkyetari Fatmir Iska, bashkë me përfaqësues të OVL - UÇK-së e bashkëpunëtorë të tjera, nderuan heroizmin e dëshmores Hadije Spahiu nga Rahoveci. Luftës tonë për çlirimin e vendit iu bashkuan djem e vajza të zonja për t'i dalë në mbrojtje vendit, e tillë ishte edhe Hadije Spahiu, e cila nuk kurseu asgjë, madje as jetën për lirinë e Kosovës. Gjaku i dëshmorëve është dëshmi e kohës që do të mbahet në mend gjatë e do të shkruar Historia jonë e lavdishme.

I përjetshëm qoftë kujtimi për të gjitha dëshmoret e dëshmorët e kombit!

U përvura Qendra për Zhvillimin e Karrierës në IAAP "Selajdin Mullaabazi - Mici". Ky projekt është përkrahur me 45% të mjeteve financiare nga Komuna e Rahovecit, pjesa tjetër nga Ministria e Arsimit dhe nga projekti EYE (Rritja e punësimit për të rinjtë), i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.



Në prag të 25-vjetorit të Betejës së Anadrinit, Kryetari Latifi, me bashkëluftëtarë, miq e përfaqësues të OVL të UÇK-së, kanë vazhduar me zbulimin e pllakave përkujtimore, në nderim të Javës së Dëshmorëve!

Në Malësi të Vogël, te vendi Mali i Madh, më 12 maj 1998, u vendos barrikada që pengoi depërtimin e forcave të mëdha të armikut në Anadrini, që synonin ta merrnin epërsinë ndaj nesh në betejën intensive që po bëhej në Ratkoc e në vijën për Bërtatin e Vrajakë, në mënyrë që forcat serbe ta merrnin Drenocin, vendin ku UÇK-ja vepronte publikisht.

Me vendosjen e pllakave përkujtimore, institucionalizohen vlerat e UÇK-së.

#### 5 MAJI - DITA KOMBËTARE E DËSHMORËVE TË ATDHEUT

Në komunën e Rahovecit, sot, filloi "Java e dëshmorëve", ku kryetari Latifi, bashkë me bashkëpunëtorë, bënë homazhe dhe nderime në varrezat e qytetit, e në ditët në vijim parashihet të mbahen edhe aktivitete të shumta, kushtuar jetës, veprës dhe gjakut të derdhur për liri.

Veprimtaria dhe vetëmohimi i dëshmorëve tanë, janë udhërrësim për brezat, prandaj si të tillë duhet të bëjmë përpjekje për ruajtjen e kësaj trashëgimie kombëtare.

Qoftë i paharuar kujtimi për heronjtë dhe dëshmorët e atdheut!

I përjetshëm ndër breza është 5 Maj!





Në kuadër te Javës së Dëshmorëve, në kompleksin memorial në Gradish, trupa artistike DANCE PRE FEST nga Prizreni, nën udhëheqjen e koreografit Gzim Sertolli, interpretoi shfaqjen skenike "EPOSI I KRESHNIKËVE". Aktivitetet si ky e pasurojnë dhe i japin vlerë Javës së Dëshmorëve.

Në vazhdën e shumë aktiviteteve për Javën e Deshmorëve, me bashkëpunëtorë e qytetarë, kryetari Latifi, ka përvuar kubëzimin e pesë segmenteve rrugore në Hoçë të Vogël, në gjatësi prej 729 metrash.

Ky projekt është investim i Komunës së Rahovecit, i cili ka për qëllim përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe lehtësimin e qarkullimit për qytetarët.



 Kryetari Smajl Latifi, priti në takim znj. Silvia Susnjic, udhëheqëse e projektit, z. Jetmir Bakija, zëvendës shef i projektit dhe znj. Rozafa Ukimera, këshilltare e projektit.

Diskutuan mundësinë e bashkëpunimit në Aktivitetin e USAID-it - Kontrata Sociale.

Natyrisht se bashkëpunime të tilla janë të mirëseardhura dhe Komuna e Rahovecit shpreh gatishmërinë.

Në 24 - vjetorin e rënies, u kujtuan heroizmi i pashoq i eprorit të UÇK-së, heroit BEDRUSH GASHI. Në vendin e quajtur Vlora, të inspiruar nga Vlora e Ismail Qemalit, Bedrushi, me rezistencën e tij, tregoi se si duhet vendi.

Me aktin heroik të tij, nderoi veten dhe luftën, pasuroi traditën luftarake të shqiptarëve dhe i dha jehonë këtyre bjeshkëve, pa u tundur për së gjalli nga pozicioni i vet deri në vetëmohim.



Nga Kryetari Latifi, drejtorët e drejtorive e bashkëpunëtorët, u kujtuan ata që në fushë të nderit ranë, dëshmorët e parë të lirisë, MILAIM KRASNIQI nga Pastaseli dhe ELMİ MORINA nga Vrajaka, u plagosën bashkëluftëtarët Osman Zyberaj, Myfterem Gashi nga Drenoci, si dhe luftëtarë i orëve të para, tashmë dëshmori LULZIM SH. HOTI nga Ratkoci, i cili si pasojë e plagëve që mori, pas luftës, ndërroi jetë.

#### PAMJE NGA MANIFESTIMI QENDROR NË RATKOC ME RASTIN E PËRVJETORIT TË 25-TË TË BETEJËS SË ANADRINIT



Kryetari Latifi, me familjarë, bashkëluftëtarë dhe qytetarë të pranishëm, në Gexhë përkujtuan heroin MEHEDIN MORINA nga Gllareva e Klinës dhe bashkëvendësit tanë të vrarë nga pushtuesit serb.

Në pjesën e parë të majit 1998, lufta e armatosur për liri mori përmasa dhe po shtrihej nga dita në ditë. Pas betejës së suksesshme të UÇK-së ndaj forcave serbe, e cila u zhvillua me 12 maj 1998 në Ratkoc, Malësi e Vogël, Vrajakë e Bërtatin, rrafshi i Anadrinisë u shndërrua në Zonë të Lirë.



#### DISA PAMJE NGA TRI NETËT E FESTIVALIT FOLKLORIK "ANADRINIA JEHON"



Kryetari Latifi, me bashkëpunëtorë e qytetarë të shumtë, kujtuan politologun, atdhetarin, profesorin, Mr. Ukshin Hoti, në 24-vjetorin e zhdukjes së tij

Unik në mendime e në veprime, Ukshin Hoti rrezaton dije, guxim, vetëmohim, përkushtim e qëndresë stoike në pikëpamjet e tij politike shkencore e atdhetare. Askush më mirë dhe më quartë se Ai nuk e artikuloi kërkesën e shqiptarëve për liri e bashkim, sepse ishte i vetëdijshëm se në skenën politike botërore mund të hyhej vetëm duke qenë të lirë dhe të fortë ekonomikisht, politiksht e ushtarakisht.

Duke qenë shumë hapa para bashkëkohanikëve, por edhe të disa brezave më pas, emri, jeta dhe vepra e tij mbeten shembelltyrë tani dhe në të ardhmen.



Kryetari Latifi, së bashku me familjarë, bashkëpunëtorë e miq, në 24 - vjetorin e rënies, nderuan kujtimin për luftëtarin e UÇK- së, dëshmorin e kombit, Sadri Fazli Krasniqi, si dhe kujtimin për martirët: Jakup A. Krasniqi, Muharrem Morina, Shaban Z. Krasniqi, Sali S. Krasniqi, Fadil B. Krasniqi dhe Merdete V. Morina, nga fshati Senoc.



Liria është fituar me gjak dhe jetët e njerëzve që e kanë vulosur, porse ajo ndërtohet, fuqizohet me punë e përkushtim të pandalshëm, gjithnjë duke i respektuar vlerat tonë kombëtare e historike, dëshmorët dhe martirët, të cilët janë dhimbja, nderi dhe krenaria e popullit tonë.

Kryetari Latifi, bashkë me z. Nijazi Makshana, koordinator i Fondacionit "Shiqiri Makshana", nënshkruan një memorandum të bashkëpunimit.

Me anë të kësaj marrëveshjeje, fondacioni merr përsipër ndarjen e katër bursave për studentë, kryesisht nga familjet e kategorive të dala nga lufta.

Kjo marrëveshje do të vlejë për 5 vjet.  
Faleminderit Fondacionit "Shiqiri Makshana"!



Kryetari Latifi, në atmosferë festive dhe në prani të nxënësve, mësimdhënësve, veteranëve të arsimit dhe shumë qytetarëve të Krushës së Madhe, përruan objektin e ri të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Bajram Curri".

Të pranishëm në këtë manifestim festiv në përurimin e shkollës së re ishin edhe Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti dhe ministria e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, znj. Arbërie Nagavci.

#### PËRFUNDOI MBLEDHJA E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA, E PESTA PËR KËTË VIT KALENDARIK

Udhëhequr nga Kryesuesi, Defrim Kafexhiu, sot, është mbajtur mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2023.

Të pranishëm në mbledhje, përvçe anëtarëve të komitetit, si zakonisht, ishte edhe nënkyetari Fatmir Iska dhe drejtori i drejtorive komunale.





## DITA NDËRKOMBËTARE E MUZEVE

Në shënim të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, në mjediset e Muzeut Komunal “Ali Haska”, në Rahovec, u organizua një aktivitet informues me nxënës dhe të rinj të komunës së Rahovecit. Për rolin dhe rëndësinë e muzeve, në prezantimin e vlerave kulturore e historike të një populli, nxënësve iu foli etnologu Irfon Ramadani. Rreth gjendjes së muzeut komunal dhe përpjekjeve për ta pasuruar atë me artefakte, të rinjve iu foli drejtori i DKRS-së, Afrim Dina.

Edhe një zotim publik i përbushur - Funksionalizimi i sistemit "One Stop Shop" në Administratën e Komunës së Rahovecit. Sot u instalua pajisja digitale për menaxhimin e radhës, që e kompletion infrastrukturën e nevojshme, që qytetarët tanë, të gjitha shërbimet administrative, t'i kryejnë në një vend dhe te një zyrtar. 25 shërbime kryesore ofrohen brenda kësaj qendre dhe 190 nënshërbime të tjera nga kjo qendër adresohen në të gjitha drejtoritë e Komunës së Rahovecit.




Nënkyetari Iska mori pjesë në Konferencën paraofertuese për Ankandin Solar 100 MW, organizuar nga Ministria e Ekonomisë, në bashkëpunim me USAID-in.

Roli i Komunës së Rahovecit, përgjatë këtij procesi, ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë i rëndësishëm.

Komuna e Rahovecit ka mbështetur dhe do ta mbështesë këtë projekt që do ta bëjë komunën e parë me një projekt kaq të madh të energjisë së ripërtëritshme.

Bashkë me Ministren e Ekonomisë, znj Artane Rizvanollı, Kryetari Latifi vizitoi Kramovikun dhe Gurin e Kuq, ku do të ndërtohet Parku Solar për energji të ripërtëritshme, i pari i këtij lloji në Kosovë, në kapacitet prej 100 MW. Ndërtimi i këtij centrali solar paraqet një hap të rëndësishëm drejt një të ardhmeje më të gjelbër për komunitetin tonë.

Komuna e Rahovecit e ka bërë të qartë synimin e saj për t'i krijuar kushtet për zhvillim afatgjatë e të qëndrueshëm.



Në kujtim dhe nderim të sakrificës sublime për lirinë e Atdheut, kryetari Latifi, me bashkëpunëtorë, bënë homazhe në Hamoc, ku prehen djemtë më të zotët e këtij populli, dëshmorët: Sadedin Hajda dhe Mexhit Mustafa. Lavdi dëshmorëve që i përjetësuan emrat e tyre në histori në betejën e përgjakshme dhe heroike të Hamocit!

Kryetari Latifi, me bashkëpunëtorë, veteranë dhe familjarë të të rënëve për liri, në varrezat e dëshmorëve në Rahovec dhe te lapidari në Hamoc, nderuan kujtimin për ata që sakrifikuani jetën e tyre për lirinë e Kosovës.

Në 24 vjetorin e përjetësimit, kujtuan dëshmorët Bekim Sylka, Besim Kabashi dhe Avni Thaçi.





Me rastin e 25-vjetorit të rënies heroike në fushë të nderit të Heroit të Kombit, luftëtarit të orëve të para, Feim Gashi nga Drenoci, të dëshmorëve të lirisë, Përparim Thaçi nga Landovica dhe Sakip Bellaqa nga Pataqani i Epërm, Kryetari Latifi, me familjarë, bashkëluftëtarë, bashkëpunëtorë dhe miq, kanë bërë homazhe në vendin ku ata ranë në pritën armike, ndërmjet Fortesës dhe Xërxeës.

Në 24-vjetorin e rënies heroike të dëshmorëve të lirisë, Milaim Morina dhe Xhevdet Krasniqi, në afërsi të Celinës, së bashku me familjarë, bashkëluftëtarë, miq e bashkëpunëtorë, Kryetari Latifi ka bërë homazhe në kujtim të veprës dhe sakrificës sublime përlirinë e atdheut.



Në Brestoc, në përvjetorin e 24-të të rënies, kryetari Latifi me bashkëpunëtorë, nderuan kujtimin përdëshmorët Alajdin Elshani, Xhevati Elshani që përjetësuan në luftimet me forcat serbe, më 28 maj 1999, si dhe kujtimin për Selim Berishën, i rënë më 27 maj 1999, pasi u fut në bunkerin e forcave armike.

Kryetari Latifi me bashkëpunëtorë, kujtuan dëshmorët e atdheut që ranë heroikisht në Betejën e "Mileskës", më 28 maj 1999. Me 28 maj 1999 ranë: komandant Mensur Zyberaj - 500-shi, luftëtarët shembullorë që nderuan armët e tyre për liri, Habib Gashi nga Nagaci, Ismail Gashi nga Krusha e Madhe, Bedri Berisha nga Volljaka e Klinës, Nazmi Hasani e Kurtish Hasani nga Randobrava e Prizrenit.



Shënohet Dita e Qendrës së Kulturës "MENSUR ZYBERAJ" në Rahovec



## PËRFUNDIM

*Ky buletin përbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë muajit maj 2023.*

*Fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, e një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendor është liria e informimit.*

*Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin, porse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij buletini mujar ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t`iu dhënë mundësi qytetarëve që të njojin dhe vlerësojnë punën e institucioneve komunale.*

*Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.*

*Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gjelqinë zyrtarët publik në nivel lokal.*

*Rahovec, maj 2023*